



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:141043

Datë: 17.06.2022

Numri i dokumentit: 03144917

PKR.nr.215/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B. (T.) Sh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.123/2020, të datës 17.11.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 15.06.2022, në prezencën e Prokurores së shtetit Ardita Beqiri-Hyseni, të akuzuarit B. Sh. si dhe mbrojtëses së tij av. Edona Sina, me datën 17.07.2022 mori dhe publikisht shpalli, dhe në të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. SH.** nga i ati T. dhe e ëma R. e gjinise G., i lindur me dt..... në Gjakovë, ku edhe banon ne rrugën “A. I.” pn, i martuar, atë i pesë fëmijëve, I papunë, ka të kryer tri vjet të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ID-....., i nacionalitetit Rom, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës-Istog, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj gjykate.

ËSHTË FAJTOR

Pa autorizim dhe me qëllim shitje ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë në atë mënyrë që me dt.11.10.2020, rreth orës 21.00 në Rr.”A. I.“në Gjakovë, pasi që patrulla e Policisë kanë arrestuar të pandehurin B. sipas Urdhëresës së Gjykatës P.nr.209/19, PED.nr.161/20, EDGJ.nr.162/20, i njëjti iu ka treguar zyrtarëve policor se ne shtëpinë e tij posedon edhe një sasi të narkotikut ashtu që pas një kontrolli në shtëpinë e të pandehurit, saktësisht ne pjesën e pasme të shtëpisë, në një livadh, përfundi disa kartonëve dhe disa mbeturinave janë gjetur 39 qese të vogla najloni të mbushura me substance narkotike ne formë bari ngjyre e bardhë e llojit Marihuan, në peshë rreth 13.44 gram, e cila sasi me pas është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

-me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, nen prg 1.2 nenit 72 par. 1 nën par. 1.4, 267 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, të cilin dënim do ta vuaj në afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 (tre qind) € të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund te ekzekutohet ne forma tjera te parapara me nenin 43 prg 3 te KPRK-se, dënimi i caktuar me gjobe do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 ditëve duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Konform nenit 267 prg 5 te KPRK-se, konfiskohet ne mënyre te përhershme lënda narkotike të llojit marihuna ne peshe prej 13.44 gram.

Urdhërohet Stacionit Policor ne Gjakove, qe pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi te beje shkatërrimin e substancës narkotike të llojit marihuan ne peshe prej 13.44 gram, qe ne polici evidentohet sipas numrit rastit 2020-DHTN-492 të datës 12.10.2020.

Detyrohet i akuzuari që ne emër te paushallit gjyqësor në shumë prej 30(tridhjetë) €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 (pese dhjete) €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.123/2020, të datës 17.11.2020, kundër të akuzuarit B. (T.) Sh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 15.07.2021, në të cilin kanë marr pjesë Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni, i akuzuari B. Sh. si dhe mbrojtësja e tij av. Edona Sina nga Gjakova, e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiri-Hyseni, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari Besnik Shotani, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i ngarkohet sipas aktakuzës, i kërkoj falje gjykatës dhe premton se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, jam mbajtës i vetëm i familjes atë

i pesë fëmijëve të mitur, dhe tani jam në vuajtje të dënimit për llojin e njëjtë të veprës penale dhe jam në rehabilitim dhe trajtim mjekësor, andaj kërkoj nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj..

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të pandehuri ka deklaruar se këtu i pandehuri B. Sh. në këtë shqyrtim fillestar pranoi fajësinë për veprën penale nga aktakuza dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësja e tij av. Edona Sina, pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet dhe pa presion, duke kuptuar pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat e siguruara gjatë kësaj faze të hetimeve e të propozuara në aktakuzë. andaj i propozoi gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovoi.

Mbrojtësja e të akuzuarit av.Edona Sina duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë ka deklaruar se: meqenëse me të mbrojturin tim jam konsultuar mjaftueshëm lidhur me pasojat dhe favorët e pranimit të fajit, në mënyrë të vullnetshme pranon fajin për veprën penale që i vihet në barrë. Andaj i propozoi gjykatës që këtë pranim të fajësisë të e aprovoi. Po ashtu theksoi se i mbrojturi edhe pse është emër i njohur për gjykatën të gjitha veprat e tij kanë të bëjnë me posedimin e narkotikëve dhe se i njëjti në të kaluarën e tij ka pasur probleme serioze nga varësia e drogës. Mirëpo shihet dukshëm që edhe sot në këtë seancë gjendja e tij fatmirësisht është përmirësuar, ka dallim të dukshëm që nga vitit 2020 kur ka ndodhur rasti deri me sot, i njëjti është koshi ent, dhe e kupton shumë mirë natyrën e kësaj vepre, dhe i premtion gjykatës që ky do të jetë rasti i fundit ku do të përfshihet qoftë në posedim apo në shitblerje të narkotikëve. I mbrojturi imë ka nevojë që ende të vazhdoi trajtimin mjekësor, andaj bazuar në këto rrethana e lus gjykatën që të shqiptoi një dënim sa më të butë ndaj tij.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij av. Edona Sina, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë Kryetari i Trupit Gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari B. Sh., me dashje ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin B.Sh. e ka shpallur fajtor për veprën penale ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij, është i moshës së re, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, si dhe gjendjen e tij ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, atë i pesë fëmijëve, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkt të tij të kjo veprë penale, shkallen e përgjegjësisë penale, kontributin e tij esencial në kryerjen e kësaj veprë penale, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë të shprehura në Kosovë në tendencë të rritjes, rrezikshmërinë që paraqet kjo veprë penale, ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar burg dhe gjobe si në dispozitiv të këtij aktgjykimit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 282 par.1 dhe 2 të KPP-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK, ka shqiptuar dënimin plotësues ashtu që është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike “marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 13.44 gram, dhe e njëjta substancë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.215/20, të datës 17.06.2022

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.